



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Lipjan, 08.06.2023

## **Procesverbali i dëgjimeve Buxhetore për kornizën afatmesme buxhetore 2024 – 2026 me qytetarët e Gadimes**

|                                     |                                                                        |
|-------------------------------------|------------------------------------------------------------------------|
| <b>Vendi i takimit:</b>             | Shkolla fillore “Zenel Hajdini”, Gadime                                |
| <b>Ora:</b>                         | 17:30                                                                  |
| <b>Përfaqësuesit institucional:</b> | Latif Ramadan, Bekim Shabani, Rexhep Rexhepi, Sead Aliu, Visar Kozhani |
| <b>Pjesëmarrësit</b>                | Qytetarët e Gadimes                                                    |
| <b>Përgatitja e procesverbalit</b>  | Grupi punues për hartimin e planifikimit të projekt buxhetit 2024-2026 |
| <b>Numri i pjesëmarrësve:</b>       | 15                                                                     |
| <b>Burra:</b>                       | 14                                                                     |
| <b>Gra:</b>                         | 1                                                                      |

### **Prezantimi i Buxhetit:**

Drejtori për Buxhet dhe Financa Latif Ramadani, ka bërë hapjen e takimi dhe ka prezantuar planifikimin e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2024-2026.

Gjatë këtij takimi drejtori për Buxhet dhe Financa ka prezantuar planifikimin e buxhetit të Komunës së Lipjanit dhe ka pranuar të gjitha kërkesat që kanë dalur nga këto takime. Ai po ashtu ka inkurajuar qytetarët që të marrin pjesë sa më shumë në këto takime sepse kanë rëndësinë e veçantë dhe është mundësia më e mirë për përfshirjen e kërkesave të qytetarëve. Si dhe ka falënderuar për pjesëmarrjen në takimin e parë për kornizën afatmesme buxhetore 2024 – 2026 me theks të veçantë investimet kapitale dhe investimet tjera të cilat do ti bëjë komuna për gjatë viteve 2024 – 2026.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

#### **Pyetjet e qytetarëve:**

**Fatmir Maliqi** – Kërkesë rrugën për të varrezat nuk besoj që është më shumë se një kilometër tek varrezat që të shtrohet me asfalt.

**Driton Shabiu** – Unë i bashkohem kërkesave paraprake, në rrugën Rexhep Sahiti është një restorant dhe po është shumë i frekuentuar prej qytetarëve edhe po vozitin shumë shpejt andaj unë kërkoj që të vendosen disa pengesa pasi që ka lëvizje të madhe të veturave dhe po vozitin shpejt aty kemi pasur edhe aksidente prandaj është mirë që aty të vendosen pengesa në rrugë, kërkesa e dytë është salla e sportit do të ishte mirë që të ndërmerret diçka pasi që kjo që është, është tejet e dëmtuar sidomos çatia e sallës është shumë e demtuar, andaj nëse ka mundësi të rinovohet.

**Argjent Tasholli** – Fillimisht ju përgëzoj për lokacionin që e keni nda për klubin e futbollit të Gadimes në pjesën me Babush anej, kërkesën e kam prej drejtorit të klubit ku kanë kërkuar që të bëhet një stadium me kushte minimale që ju lejohet me i zhvillu lojë në këtë ligë, kërkesë tjetër që kemi është shkolla pavarësisht që shkolla është shumë e mirë por kemi nevojë shumë për kabinete siç është kabineti i Tik-ut ndërsa tash po ndërlihdna të kërkesa e profes tek salla e sporteve unë mendoj që ka qenë kërkesë e vazhdueshme për një sallë të re duke e pas parasysh që prej pas luftës është rinovuar një 10 herë por prap nuk i ka plotësura kushtet as njëherë edhe kur ka qenë partia jem në pushtet por edhe ju është investura por përsëri nuk i ka plotësuar kushtet e çka është tjetër na e kemi edhe klubin e volejbollit se Gadimja shquhet për volejball e salla të cilën e kemi nuk i plotëson standardet për të luajtur, loja e volejbollit është kërkesë e jona pasi e kemi edhe klubin kërkojmë me bo një sallë si në fshatrat tjera besoj që do të ishte më mirë e këtë me hejë krejt e me bo një sallë të re.

**Bekim Shabani** – Tek ne në Gadime të Epërme na duhen diku rreth 1000 deri në 1500 metra asfalt për me i asfaltuar disa rrugica andaj do të ishte mirë të parashihen në rishikim ose në bartje që të kryhen këto rrugica të cilat kanë mbetur e s'besoj që janë më shumë se 1000 metra asfalt.

**Albiona Tasholli asambliste e LDK** – Çka është mirë me u rregullu edhe në Gadime të Ulët por edhe në Gadime të Epërme hapësirat publike ku janë, duhen do shenja sinjalizuese kur të vina prej Lipjanit se për shkak disa nuk e din shembull lumi që është poshtë, vjet ka ndodh një aksident.

**Hazbi Ademi** – Kam një kërkesë modeste është ndërtuar fusha e futbollit por i mungojnë ulëset andaj nëse ka mundësi me i parapa ulëset për shikues.